



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 3 Nëntor 2022

Nr: 3

UDHËZIM

PËR
PËRCAKTIMIN E KRITEREVE PËR PËRZGJEDHJEN E MONITORUESVE NË
ZGJEDHJE DHE RREGULLAT PËR MONITORIMIN

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronjat “ë” dhe “n”, e 2, dhe nenit 92/4 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

U D H Ë Z O J:

Neni 1

Qëllimi

Ky udhëzim ka për qëllim të përcaktojë:

- objektin dhe periudhën e monitorimit të fushatës zgjedhore,
- kriteret e përzgjedhjes dhe procedurën e emërimit të monitoruesve,
- dhe formatin e raportimit të monitorimit nga monitoruesit.

Neni 2

Periudha e monitorimit

- Periudha e monitorimit fillon 4 (katër) muaj para datës së zgjedhjeve dhe përfundon ditën e zgjedhjeve deri në orën e mbylljes së votimit.

Neni 3

Objekti i monitorimit

- Objekti i monitorimit është fushata zgjedhore e partive politike dhe/ose subjekteve zgjedhore gjatë fushatës, duke synuar vlerësimin e shkallës së përputhshmërisë së veprimtarisë së



partive politike, subjekteve zgjedhore, kandidatëve për deputetë, kandidatëve për kryetarë bashkie dhe këshillat bashkiakë me kërkesat e Pjesës VII, të Kreut I, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe përcaktimet e parashikuara me akte të tjera nënligjore të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

2. Monitoruesit vëzhgojnë edhe veprimtarinë e organeve të administratës shtetërore qendrore ose vendore, apo titullarëve të tyre në raport me zbatimin e detyrimeve të përcaktuara në Pjesën VII, Kreu I të Kodit Zgjedhor, si dhe aktet e tjera nënligjore të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Monitorimi kufizohet në vëzhgimin lehtësisht të verifikueshëm të respektimit të përmbushjes së detyrimeve nga ana e partive politike, subjekteve zgjedhore dhe kandidatëve për periudhën e monitorimit, mbi:
 - a) Organizimin e takimeve, veprimtarive e tubimeve elektorale,
 - b) Përdorimin e materialeve propagandistike, ngritjen dhe veprimtarinë në zyrat zgjedhore,
 - c) Respektimin e ndalimeve dhe kufizimeve për veprimtari të caktuara para datës së zgjedhjeve si dhe përdorimin/shpërdorimin e burimeve shtetërore gjatë periudhës së monitorimit,
 - ç) Monitorimin e mediave online si dhe të rrjeteve sociale të tilla por jo vetëm, Facebook, Instagram, lidhur me aktivitetet institucionale, aktivitetet elektorale të subjekteve zgjedhore, si dhe faqet e sponsorizuara nga partia dhe/ose kandidatët.

Neni 4

Modalitetet e monitorimit dhe mënyra e raportimit

1. Monitoruesi duhet të ushtrojë përgjegjësitë dhe të kryejë detyrat e tij në mënyrë të pavarur, të paanshme, jo diskriminuese dhe transparente. Monitoruesi gjatë periudhës së monitorimit nuk mund të kryejë veprimtari që bien ndesh me qëllimin e monitorimit.
2. Monitoruesi mbledh informacionin për monitorimin e partive politike, subjekteve zgjedhore dhe kandidatëve mbështetur në:
 - a) vëzhgimin e drejtpërdrejtë të aktiviteteve të partisë politike, subjektit zgjedhor, kandidatëve dhe të organeve të administratës shtetërore qendrore ose vendore, si dhe titullarëve të tyre,
 - b) intervistat me kandidatët ose kryetarët/përfaqësuesit e partive politike, drejtuesit e fushatës së partive politike/subjekteve zgjedhore si dhe stafit mbështetës të tyre,
 - c) identifikimin dhe vëzhgimin e drejtpërdrejtë të zyrave zgjedhore dhe të materialeve propagandistike,

- ç) identifikimin dhe vëzhgimin e drejtpërdrejtë të takimeve, veprimtarive e tubimeve elektorale të partive politike, subjektet zgjedhore dhe kandidatët.
3. Monitoruesi mbledh informacion për monitorimin e veprimtarisë së institucioneve të administratës shtetërore qendrore ose vendore, apo titullarëve të tyre nëpërmjet:
 - a) vëzhgimit të drejtpërdrejtë të aktiviteteve të tyre,
 - b) vëzhgimit të mediave për identifikimin e veprimtarive të institucioneve publike.
 4. Monitorimi nuk duhet t'i ekspozojë monitoruesit ndaj rreziqeve të panevojshme.
 5. Monitorimi nuk kërkon që monitoruesit të llogarisin shpenzimet totale për periudhën e monitorimit nga partia politike, subjekti zgjedhor ose kandidatët ose variablat e ndryshme financiare, që kërkojnë mbledhje të metadatave të zgjeruara.
 6. Monitoruesi ka të drejtë të kërkojë nga subjektet që i nënshtrohen monitorimit, sipas këtij udhëzimi, të vendosin në dispozicion të tij informacionin për veprimtaritë e tyre. Kërkesa nga monitoruesit paraqitet me shkrim duke vënë në dijeni në të njëjtën kohë Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dhe në rast se marrësi nuk i përgjigjet asaj brenda 3 (tre) ditëve, monitoruesi njofton menjëherë Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.
 7. Në rast konstatimi të një shkeljeje flagrante, monitoruesi njofton menjëherë Komisionin Qendror të Zgjedhjeve me çdo mjet komunikimi, dhe plotëson raportin sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr. 1, që i bashkëlidhet këtij udhëzimi.
 8. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve mund t'i kërkojë monitoruesit informacion shtesë për shkeljet e pretenduara.
 9. Monitoruesi duhet të depozitojë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve raportet e ndërmjetme të monitorimit, në çdo 10 (ditë) sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr. 1 dhe nr. 2, që i bashkëlidhen këtij udhëzimi.
 10. Jo më vonë se 7 (shtatë) ditë pas ditës së zgjedhjeve, monitoruesi depoziton në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve raportin përfundimtar të monitorimit, sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr. 1 dhe nr. 2, që i bashkëlidhet këtij udhëzimi.
 11. Monitoruesit kanë detyrimin të depozitojnë raportet përkatëse të monitorimit edhe në formatin elektronik, nëpërmjet një platforme online, kur kjo ju kërkohet nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Pavarësisht këtij parashikimi monitoruesit kanë detyrimin që raportet përkatëse t'i dorëzojnë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve edhe në formë të printuar me nënshkrimin përkatëse.

Neni 5

Thirrja për rekrutim të monitoruesve

1. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve përzgjedh monitoruesit jo më vonë se 6 (gjashtë) muaj përpara datës së zgjedhjeve Procedura e përzgjedhjes dhe e nënshkrimit të kontratës përkatëse bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, si dhe këtë udhëzim.
2. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve shpall publikisht thirrjen për aplikim për monitorues të fushatës zgjedhore. Thirrja përmban kushtet dhe kriteret që duhet të plotësojnë personat që do të caktohen si monitorues.
3. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve cakton me vendim numrin e monitoruesve në çdo zgjedhje dhe për çdo zonë zgjedhore.

Neni 6

Kriteret dhe mënyra e aplikimit

1. Kriteret për të aplikuar si monitorues janë si vijon:
 - a) të jetë i padënuar,
 - b) të ketë përfunduar studimet universitare ose të jetë duke ndjekur një program studimi në një nga institucionet e arsimit të lartë,
 - c) të mos jetë anëtar i ndonjë partie politike të paktën 2 (dy) vitet e fundit.
2. Aplikantët për monitorues duhet të paraqesin dokumentacionin si më poshtë:
 - a) kërkesën për t'u emëruar si monitorues që përmban: qarkun për të cilin aplikon, përvojën e aplikantit dhe adresën e banimit, adresën e postës elektronike (e-mail) dhe numrin e tel./cel.,
 - b) dëshmi penaliteti,
 - c) kopje të noterizuar të diplomës ose vërtetim që është duke ndjekur një program studimi në një nga institucionet e arsimit të lartë të noterizuar,
 - ç) kopje të dokumentit të identifikimit,
 - d) vetëdeklarim se nuk është anëtar i ndonjë partie politike për 2 (dy) vitet e fundit, sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr. 3, që i bashkëlidhët këtij udhëzimi,
 - dh) raport të aftësisë për punë,
 - e) vetëdeklarim i banimit,
 - ë) fotokopje e certifikatës si monitorues në zgjedhje të mëparshme (nëse disponojnë).
3. Në momentin e regjistrimit të kandidatëve për deputetë, kryetarë bashkie ose anëtarë të këshillit bashkiak, monitoruesit depozitojnë formularin e dytë për mungesën e konfliktit të

interesit, sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr. 4, që i bashkëlidhet këtij udhëzimi. Në këtë rast monitoruesit deklarojnë se nuk janë në konflikt interesi për shkak se nuk kanë prindërit, bashkëshortin/bashkëshorten, bashkëjetuesin/bashkëjetuesen ose fëmijët madhorë kandidatë të subjekteve zgjedhore. Në rast të kundërt, monitoruesit i ndërpritet kontrata e shërbimit dhe zëvendësohet në këtë detyrë nga një monitorues tjetër.

4. Mosdeklarimi i saktë i të dhënave ose deklarimi i rremë nga ana e monitoruesve, passjell për deklaruesin përgjegjësi sipas ligjit.

Neni 7

Verifikimi paraprak dhe procedura e certifikimit si monitorues

1. Jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga përfundimi i afatit të aplikimit, struktura përgjegjëse në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve verifikon nëse aplikanti përmbush kushtet dhe kriteret për monitorues sipas përcaktimeve të këtij udhëzimi. Lista e aplikantëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret miratohet nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.
2. Aplikantët e përzgjedhur i nënshtrohen trajnimit si dhe testimit me shkrim, të organizuar nga administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Përjashtohen nga testimi aplikantët të cilët zotërojnë Certifikatën e Monitoruesit. Aplikanti i cili kalon testimin pajiset me Certifikatën e Monitoruesit.
3. Certifikata merret vetëm një herë dhe është e vlefshme vetëm nëse monitoruesi ndjek së paku 70% të trajnimeve vazhduese të organizuara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ndërmjet dy zgjedhjeve të njëpasnjëshme të përgjithshme.
4. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve përjashton nga procedura rekrutimit, personat të cilët nuk kanë përmbushur detyrimet kontraktuale me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Përjashtimi shtrihet në 2 (dy) zgjedhje të përgjithshme të njëpasnjëshme.

Neni 8

Procedura e caktimit të monitoruesve

1. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve cakton me short monitoruesit për çdo zonë zgjedhore. Shorti hidhet ndërmjet personave që zotërojnë Certifikatën e Monitoruesit. Procedura e shortit është publike.
2. Territori gjeografik i monitorimit brenda zonës zgjedhore përcaktohet në kontratën që lidhet ndërmjet Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe monitoruesit.
3. Monitoruesit regjistrohen në Regjistrin e Monitoruesve që mbahet dhe përditësohet nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Neni 9

Administrimi i raporteve të monitorimit

1. Raportet e monitorimit publikohen në faqen e internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në mënyrë periodike.
2. Për qëllim të auditimit të raporteve financiare të subjekteve zgjedhore dhe kandidatëve të tyre, raportet e monitorimit ju vihen në dispozicion audituesve ligjorë nga administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Neni 10

Personat përgjegjës për zbatimin e udhëzimit

Ngarkohet administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe monitoruesit për zbatimin e këtij udhëzimi.

Neni 11

Shfuqizim

Udhëzimi nr. 1, datë 2.2.2021, i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për caktimin e kritereve për përzgjedhjen e monitoruesve, procedurën, emërimin dhe objektin e monitorimit”, shfuqizohet.

Neni 12

Hyrja në fuqi

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Iirjan CELIBASHI



(Shtojca nr.1)

KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Monitorimi i Fushatës Zgjedhore

Raporti i shkeljeve

[] DITOR

[] PERIODIK

[] PËRFUNDIMTAR

I. Informacione identifikuese

Emër Mbiemër (Monitoruesit)	
NID	
E-mail (Monitoruesit)	
Numër telefoni mobil (Monitoruesit)	
Lloji i Zgjedhjeve	Zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, të datës _____ [] Organet e Qeverisjes Vendore, të datës _____ []
Subjekti Zgjedhor i monitoruar	Partia _____
Data kur ka filluar monitorimi	(dd.mm.vvvv)
Data kur ka mbaruar monitorimi	(dd.mm.vvvv)
Data e dorëzimit të raportit:	(dd.mm.vvvv)
Nënshkrimi	

Raport mbi SHKELJET e Subjektit Zgjedhor _____

Nënshkrim Monitoruesit



III. Legjenda e shkeljeve të konstatuara:

- (A) - Zhvillimi i takimit elektoral në shkollë (neni 91, pika 2, Kodi Zgjedhor);
- (B) - Zhvillim i fushatës në institucion publik (Neni 78, pika 6, Kodi Zgjedhor);
- (C) - Vendosja e posterave elektoral në institucion publik (Udhëzimi nr.6, datë 23.03.2021, i KSHZ-së);
- (D) - Subjektet zgjedhore/kandidatët i ofrojnë ose japin para, të mira materiale, premtojnë vende pune (neni 78, pika 7, Kodi Zgjedhor);
- (E) - Subjekti zgjedhor/kandidati organizon ose mbulon shpenzimet për koncerte, evente kulturore dhe argetuese ose aktivitete bamirësie (Neni 78, pika 9, Kodi Zgjedhor);
- (F) - Subjekti zgjedhor/Kandidati që ofron artikuj ose materiale të printuara me vlerë prej më shumë se 5(pesë) qind Lekë për artikuj ose materiale zgjedhore (Neni 78, pika 10, Kodi Zgjedhor);
- (G) - Paraqitja e materialeve propagandistike statike më shumë se 5 metra nga zyrat zgjedhore (Neni 79, pika 2, Kodi Zgjedhor);
- (H) - Mos përfshirja e deklaratës së autorizimit në materialet vizive të fushatës propagandistike (Neni 79, pika 3, Kodi Zgjedhor);
- (I) - Zyrat zgjedhore janë hapur në një distancë më të vogël se 300 metra nga vendndodhja e KZAZ-ve, QV-ve dhe VNV-ve. (Udhëzimi nr.6, datë 23.03.2021, i KSHZ-së);
- (J) - Materiale propagandistike të vendosura në mjete që operojnë në transportin publik (Udhëzimi nr.6, datë 23.03.2021, i KSHZ-së);
- (K) - Përdorimi i detyruar në fushatë zgjedhore i administratës së institucionit brenda orarit të punës për qëllime zgjedhor (Neni 91, pika 2, Kodi Zgjedhor);
- (L) - Punësimi, pushimi nga puna, lëvizja dhe transferimi në detyrë në institucione ose ente publike gjatë fushatës zgjedhore, përveç rasteve të justifikuara (Neni 91, pika 3, Kodi Zgjedhor);



(M) - Ndalimi në propozimin, aprovimin ose nxjerrjen e akteve ligjore ose akteve nënligjore që përfitojnë kategori të caktuara të njerëzve (p.sh. rroga, rritja e pensionit, amnistia fiskale) (Neni 91, pika 4, Kodi Zgjedhor);

(N) - Mos raportimi i aktiviteteve të natyrës publike të kryer nga institucione publike vendore dhe qendrore, si dhe agjensi shtetërore dhe/ose ndërmarrje (Neni 92, pika 1 dhe 6, Kodi Zgjedhor);

(O) - Kryerja e aktiviteteve të ndaluara nga KQZ-ja (Neni 91, pika 5, Kodi Zgjedhor dhe vendimi nr.9, datë 24.12.2020, i Komisionit Rregullator).

Raport mbi SHKELJET e Subjektit Zgjedhor _____

Nënshkrim Monitoruesit



(Shtojca nr.2)

KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Monitorimi i Fushatës Zgjedhore Raport MBI GJETJET në terren

[] PERIODIK
[] PËRFUNDIMTAR

I. Informacione identifikuese

Emër Mbiemër (Monitoruesit)	
NID	
E-mail (Monitoruesit)	
Numër telefoni mobil (Monitoruesit)	
Lloji i Zgjedhjeve	Zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, të datës _____ [] Organet e Qeverisjes Vendore, të datës _____ []
Subjekti Zgjedhor i monitoruar	Partia _____
Data kur ka filluar monitorimi	(dd.mm.vvvv)
Data kur ka mbaruar monitorimi	(dd.mm.vvvv)
Data e dorëzimit të raportit:	(dd.mm.vvvv)
Nënshkrimi	

Raport mbi GJETJET në terren për Subjektin Zgjedhor _____

Nënshkrim Monitoruesit



III. Legjenda e gjetjeve:

1. Zyrë zgjedhore = **A1**;
2. Takim zgjedhor në ambient të hapur = B1;
3. Takim zgjedhor në ambient të mbyllur = C1;
4. Takim zgjedhor në shkollë = D1;
5. Takim zgjedhor në ambiente të tjera = E1;
6. Poster zgjedhore = F1;
7. Billboard zgjedhore = G1;
8. Citylight zgjedhore = H1;
9. Fletë-palosje =I1;
10. Materiale të tjera informuese, edukuese, reklamuese, etj, (sipas Udhëzimit nr.6, datë 23 Mars 2021 i KSHZ) =J1;
11. Set pajisje zyre = K1;
12. Pajisje audio e përdorur për qëllime takimesh zgjedhore = L1;
13. Pajisje video me ekran jo më ta madh se 65" = M1;
14. Pajisje video me ekran më të madh se 65" = N1;
15. Pajisje tjetër e përdorur për qëllime zgjedhore = O1.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

DEKLARATË

MBI MUNGESËN E KONFLIKTIT TË INTERESIT TË MONITORUESIT

[Për Zgjedhjet]

Sot më datë:

Unë deklарuesi:

Banues në:

DEKLAROJ:

Nuk jam në kushtet e konfliktit të interesit që parashikon ligji nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, dhe udhëzimi nr. 3, datë 03.11.2022, i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për përcaktimin e kriterëve për përzgjedhjen e monitoruesve në zgjedhje dhe rregullat për monitorimin”, pasi nuk kam qenë për 2 (dy) vitet e fundit anëtar/e i/e ndonjë partie politike.

Kujdes! Deklaruesi mban përgjegjësi personale për deklарim të rremë.

Deklaruesi

(emri, mbiemri, nënshkrimi)





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

DEKLARATË

MBI MUNGESËN E KONFLIKTIT TË INTERESIT TË MONITORUESIT
(Pas regjistrimit të kandidatëve për deputetë, kryetarë bashkie ose anëtarë të këshillit bashkiak)

[Për Zgjedhje]

Sot më datë:

Unë deklaruari:

Banues në:

DEKLAROJ:

Nuk jam në kushtet e konfliktit të interesit që parashikon ligji nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, dhe udhëzimi nr. 3, datë 03.11.2022, i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për përcaktimin e kriterëve për përzgjedhjen e monitoruesve në zgjedhje dhe rregullat për monitorimin”, pasi nuk kam prindërit, bashkëshortin/bashkëshorten, bashkëjetuesin/bashkëjetuesen ose fëmijët madhorë kandidatë të subjekteve zgjedhore.

Kujdes! Deklaruesi mban përgjegjësi personale për deklaram të rremë.

Deklaruesi

(emri, mbiemri, nënshkrimi)